

# TENDERI IM

---

ANALIZË E LEGJISLACIONIT MBI PROKURIMIN PUBLIK

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë ato të KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin ato të donatorëve.



British Embassy  
Pristina

## Personeli:

Ismet KRYEZIU - *Drejtor ekzekutiv*  
 email: ikryeziu@kdi-kosova.org

Vjollca VOGËL - *Menaxhere e administratës dhe financave*  
 email: vjollca@kdi-kosova.org

Leonora CIKAJ - *Asistente për administratë dhe financa*  
 email: lcikaj@kdi-kosova.org

## I Programi Demokratizimi dhe Praktikë Parlamentare

Driton SELMANAJ - *Menaxher i programit*  
 email: dselmanaj@kdi-kosova.org

Halil MATOSHI - *Analist*  
 email: hmatoshi@kdi-kosova.org

Isuf ZEJNA - *Analist*  
 email: izejna@kdi-kosova.org

Nevahir HAZERI - *Analist*  
 email: nhazeri@kdi-kosova.org

Florije MEHMETI - *Vëzhguese e Parlamentit*  
 email: fmehmeti@kdi-kosova.org

## II Programi Qeverisja Lokale dhe Pjesëmarrja Qytetare

**Projekti:**  
 Pjesëmarrja e qytetare dhe principet për një qeverisje të mirë

Naim CAHANAJ - *Koordinator*  
 email: ncahanaj@kdi-kosova.org

Arben HOXHAJ - *Kordinator*  
 email: ahoxhaj@kdi-kosova.org

## III Programi Transparenca dhe Kundër-korrupsioni

Merita MUSTAFA - *Menaxhere e programit*  
 email: mmustafa@kdi-kosova.org

Besnik RAMADANAJ - *Koordinator i projektit*  
 email: bramadanaj@kdi-kosova.org

Kujtim BYTYQI - *Hulumtues/Analist*  
 email: kbtytyqi@kdi-kosova.org

Enis XHEMAJLI - *Hulumtues/Analist*  
 email: exhemajli@kdi-kosova.org

Shqipe GJOCAJ - *Hulumtuese/ Analiste*  
 email: shgjocaj@kdi-kosova.org

## IV Programi Zgjedhjet e lira dhe të drejta

Liridon SELMANI - *Menaxher i programit*  
 email: lselmani@kdi-kosova.org

www.kdi-kosova.org

## PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	3
2. BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI	4
3. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE	6
• KRPP	6
• AQP	7
• OSHP	7
• IKAP	8
4. TRANSPARENCA	9
5. SANKSIONET	12
6. STANDARDET EVROPIA	14
• RAPORTI I PROGRESIT PËR KOSOVËN (2008 – 2011)	17
7. PRAKTIKAT NGA RAJONI	19
8. GRUPET E INTERESIT	22
9. PËRFUNDIMET/REKOMANDIMET	26
10. BIBLIOGRAFIA	28

## 1. HYRJE

Efikasiteti dhe transparenca në prokurimin publik vazhdojnë të jenë sfida të veçanta të institucioneve të vendit. Të gjitha raportet vendore e ndërkombëtare, raportet e Auditorit të Përgjithshëm, si dhe raportimet në media tregojnë për shkelje të vazhdueshme të procedurave tenderuese, përkatësisht shkelje të Ligjit për Prokurimin Publik

Me gjithë ndryshimet dhe plotësimet e bëra në legjislacion, edhe më tej paraqiten probleme në zbatim. Fillimisht, fusha e prokurimit publik ka qenë e rregulluar me rregullore të UNMIK-ut, e cila ka pësuar ndryshime në vazhdimësi. Ndryshimet dhe plotësimet e bëra kanë pasur për qëllim harmonizimin me standardet evropiane dhe direktivat e Bashkimit Evropian.

Me qëllim të shtjellimit të përmbajtjes së ligjit, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)/Transparency International Kosova (TIK), në kuadër të projektit “Transparenca dhe Llogaridhënia në Prokurimin Publik”, synon që nëpërmjet kësaj analize të bëjë prezantimin, krahasimin dhe analizimin e Ligjit për Prokurimin Publik, duke krahasuar kështu edhe me standardet evropiane, si dhe transparencën që krijon legjislacioni në fjalë gjatë zbatimit të tij. Në fokus të analizës do të jenë edhe objektivat, të drejtat, dhe obligimet që rrjedhin nga ky Ligj.

Vërejtjet kryesore sa i përket ligjit në të kaluarën kanë qenë kryesisht rreth harmonizimit të tij me përvojat dhe standardet më demokratike që mundësojnë transparencë të mjaftueshme dhe llogaridhënie për shpenzimin dhe menaxhimin e parasë publike. Prandaj, me anë të kësaj analize synohet po ashtu që të analizohet ajo që është bërë në harmonizimin e legjislacionit aktual me legjislacionin dhe standardet evropiane.

Megjithatë, në shumë evidenca dhe raporte të institucioneve të ndryshme flitet ende për mungesë të zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik. Edhe Raportet e Progresit të Komisionit Evropian kanë dhënë vazhdimisht vërejtje sa i përket legjislacionit që rregullon prokurimi publik. Raporti i vitit 2011, konstaton se ligji përmbante një numër të dispozitave që nuk ishin në përputhje me Direktivat e BE-së mbi prokurimin publik, e aq më keq, nënvizohet se këto dispozita ligjore “ekspozonin zyrtarët e prokurimit në ndërhyrje dhe presion politik”.

Nga ana tjetër, me gjithë avancimet që janë bërë në standardet dhe direktivat e BE-së, kjo e fundit është duke rishikuar legjislacionin mbi prokurimin publik dhe gjatë këtij viti do të përgatitën propozimet, me qëllim të thjeshtimit dhe azhurnimit të rregullave evropiane, që dhënia e kontratave të bëhet më fleksibile dhe që kontratat publike të mund të vihen në përdorim më të mirë në mbështetje të politikave tjera.

Ndërkohë, krahasimi me përvojat e rajonit do të jetë në fokus po ashtu të rëndësishëm. Për shkak të rolit të rëndësishëm që kanë, në analizë është paraqitur edhe kontributi i grupeve të interesit. Në shoqëritë demokratike, shoqëria civile luan rol qenësor në nxitjen për hartimin e legjislacionit që krijon transparencë dhe lufton dukuritë negative.

Në fund, rëndësi dhe interes të veçantë në analizimin e legjislacionit mbi prokurimin publik ka transparenca dhe mundësia e qasjes që ofrohet, si për qytetarët, ashtu edhe për mediat, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të gjitha grupet tjera të interesit. Për më tepër, zbatimi i sistemit elektronik të prokurimit publik do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe mundësisë së zvogëlimit të keqpërdorimit të parasë publike.

## 2. BAZA LIGJORE DHE QËLLIMI

Prokurimi publik në Kosovë rregullohet me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, që ka hyrë në fuqi më 5 tetor 2011. Ky ligj ka qenë vazhdimësi dhe përmirësim i legjislacionit dhe rregulloreve paraprahe.

Fillimisht, kjo fushë ishte rregulluar me rregullore të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Me qëllim të rregullimit të prokurimit publik, duke shfrytëzuar mjetet e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, UNMIK-u kishte nxjerrë një rregullore të quajtur “Instruksioni i Administrimit Financiar Nr 2/1999”.

Më pas, me themelimin e institucioneve vetëqeverisëse demokratike të Kosovës, ishte nxjerrë Ligji për Prokurimin Publik 2003/17, dhe pas shpalljes së pavarësisë u nxor Ligji për Prokurimin Publik 2009/03-L-158. Ndryshimi dhe plotësimi i fundit është bërë në vitin 2011 (04/L-042).

Ligji i ri për prokurimi publik Nr. 04/L-242, është i ndarë në dymbëdhjetë pjesë ku secila rregullon aspekte të ndryshme të procedurave të prokurimit, si dhe përbëhet nga 135 nene. Përveç përmbajtjes që flet për procedurat e prokurimit, Ligji përmban edhe qëllimet për ekonomikitet, efikasitet dhe jo-diskriminim.

Neni 6 i këtij ligji flet për Ekonomicitet dhe Efikasitet: “1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. 2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e

tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.” Kjo dispozitë ligjore e prezanton qartë qëllimin e procesit të prokurimit publik, përkatësisht, që të bëhet një menaxhim i mirë i parasë publike, të taksapaguesve.

Ndërsa, neni 7 flet për Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminim: “1. Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente...”.

Sa i përket aktiviteteve të prokurimit të Operatorëve të Shërbimeve publike, duke ditur faktin se ndërmarrjet publike operojnë në baza ditore dhe se merren me kërkesa shumë komplekse dhe specifike, ligji i ri me një kapitull të ri, e rregullon veçanërisht këtë fushë. Ky veprim i ka ndihmuar aktivitetet e ndërmarrjeve publike, duke iu dhënë atyre më shumë fleksibilitet gjatë aktiviteteve të prokurimit.

Me ligjin e ri janë bërë përmirësime edhe në lidhje me hapjen e tenderëve dhe ofertat nga operatorët ekonomik. Me këtë rast, dispozitat ligjore kanë përjashtuar zbritjet, të cilat ishin keqkuptuar nga operatorët ekonomikë dhe zyrtarët e prokurimit. Kjo pasi që zbritja ka mundur të ofrohej vetëm në rast se aktiviteti i prokurimit ka qenë i ndarë në Lote dhe nëse Operatorët Ekonomikë kanë konkurrar për disa Lote, ata kanë pasur mundësi të ofrojnë zbritje në rast se shpërblehen me më shumë se një Lot.

## QËLLIMI I LIGJIT

Rregullimi ligjor i fushës së prokurimit publik lidhet apo ka për synim shfrytëzimin më të drejtë, më efikas, më ekonomik dhe pa keqpërdorur paranë publike. Krijimi i ambienteve konkurruese dhe jo diskriminuese në prokurim publik mëtohet të jetë qëllim tjetër i ligjit.

Ligji aktual për Prokurimin publik në qëllimin e saj e thekson edhe nevojën e transparencës dhe caktimit të kushteve dhe kriterëve.

“1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në

---

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Kreu II, Neni 6.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Kreu II, Neni 7.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Pjesa V.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 58.

aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.”

Përfshirja e ndikimeve nga interesat personale në procedurat e prokurimit është një element tjetër që përmendet në qëllimin e këtij ligji.

“2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.”

### 3. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës ka përcaktuar edhe institucionet kompetente që kanë në fushë-veprimtarinë e tyre prokurimin publik. Institucionet përgjegjëse që lidhen me fushën e prokurimit janë: Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRrPP), Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP) dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP).

#### KOMISIONI RREGULLATIV I PROKURIMIT PUBLIK (KRPP)

KRPP sipas ligjit është agjenci e pavarur rregullatore, që do të thotë se asnjë zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të përpiqet të ushtrojë ndikim në KRPP në lidhje me ndonjë veprim ose vendim të caktuar operacional apo rregullativ të KRPP-së. “KRPP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. KRPP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme të ligjeve dhe rregulloreve të

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Pjesa I, Neni 1, Paragrafi 1.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Pjesa I, Neni 1, Paragrafi 2.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 86, Paragrafi 1 dhe 2.

Sa i përket funksioneve të KRPP-së, Ligji thotë se ky institucion është përgjegjëse për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë

### AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT (AQP)

Në bazë të ligjit për Prokurimin Publik, është paraparë që në Ministrinë përkatëse për Financa të themelohet Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP). AQP do të zbatojë dhe të kryej funksione dhe përgjegjësi të specifikuar në këtë ligj. Të gjitha pasuritë, duke përfshirë të gjitha arkivat dhe objektet në shfrytëzim nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe personeli i APP-së transferohen te Agjencia Qendrore e Prokurimit.

Ndërkohë, sa i përket kompetencave të AQP-së, në këtë ligj thuhet se për shkak të ekspertizës profesionale, efektivitetit të kostos, efikasitetit ose çështjeve të tjera legjitime, Ministri për financa mund të ketë autoritetin për ta përcaktuar AQP-në si autoritetin kontraktues përgjegjës për kryerjen e atij aktiviteti prokurimi. Në një rast të tillë (i) Ministri i financave njofton autoritetin përkatës kontraktues ose autoritetet, të cilat nuk janë më të autorizuar të kryejnë prokurimin në fjalë, dhe (ii) AQP, për të gjitha qëllimet e ligjit aktual, do të konsiderohet “autoriteti kontraktues” për aktivitetin në fjalë të prokurimit. Ministri i financave siguron marrëveshjen nga bordi mbikëqyrës përkatës nëse autoriteti kontraktues është ndërmarrje në pronësi publike.

### ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT (OSHP)

Organi Shqyrtues i Prokurimit në një mënyrë vlerësohet si Gjykata e proceseve të prokurimit, që shqyrton ankesat e palëve të pakënaqura. Vendimet e saj janë detyruese pas fuqizimit. Ankesat kundrejt vendimeve të OSHP-së mund të trajtohen vetëm nga Gjykata Supreme, në afatin e paraparë ligjor.

Sipas ligjit, OSHP-ja është organ i pavarur shqyrtues dhe ushtron autoritetin, kompetencat, funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë ligj. “OSHP do të jetë organ i pavarur për shqyrtim administrativ. OSHP-ja përbëhet nga pesë (5) anëtarë të Bordit. Për mbështetje administrative OSHP-së i ndihmon Sekretariati i cili udhëhiqet nga Kryesuesi i Sekretariatit. Asnjë person ose zyrtar publik nuk mund të ushtrojë ose të

---

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 87, Paragrafi 1.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 94, Paragrafi 1.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 95, Paragrafi 1.



përpiqet të ushtrojë ndikim politik ose ndikim të paligjshëm në OSHP apo ndonjë punonjësi të tij për ndonjë vendim. Ndikimi nuk do të konsiderohet politik apo i paligjshëm nëse shfaqet në mënyre të hapur, në pajtim me rregullat e ligjit dhe procedurave, dhe në besim të plotë se haptas avancohet ankesën ose mbrojtjen.” DHE “OSHP është autoritet publik dhe organizatë buxhetore. OSHP është subjekt i të gjitha dispozitave të zbatueshme, ligjeve dhe rregullore të Kosovës, në masë të njëjtë sikurse autoritetet e tjera publike dhe organizatat buxhetore.”

Sa i përket funksioneve dhe kompetencave, sipas ligjit, OSHP është përgjegjëse për zbatimin e procedurave për shqyrtimin e prokurimit sipas Pjesës IX të këtij ligji dhe kanë autoritetin dhe përgjegjësitë e parashikuara në atë Pjesë. “Në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare. 3. Të gjitha vendimet e nxjerra nga OSHP mund të shqyrtohen nga Gjykata kompetente në pajtim me ligjin për shqyrtimin gjyqësor të çështjeve administrative”.

Raporti i Progresit nga ana tjetër ka analizuar edhe punën e këtyre tre institucioneve. Në raportin e progresit të vitit 2011 thuhet se në legjislacionin aktual ka përzierje të kompetencave ndërmjet tri institucioneve të prokurimit publik. Ndërkohë edhe raportet vendore për OSHP-në theksojnë nevojën për rritjen e performancës së këtyre institucioneve.

## INSTITUTI I KOSOVËS PËR ADMINISTRATË PUBLIKE (IKAP)

Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) në bashkëpunim me KRPP-në, sipas Ligjit mbi Prokurimi Publik, është institucioni përgjegjës për trajnimin, kualifikimin dhe organizimin e provimeve të zyrtarëve të prokurimit publik. Trajnimet zgjasin 15 ditë, ndërkaq IKAP lëshon “Certifikatë themelore profesionale të prokurimit” – për personat të cilët i kanë përfunduar të gjitha kurset themelore, ndërkaq “Certifikatë të avancuar profesionale të prokurimit” për personat që kanë kaluar me sukses kurse të avancuara, ndërkaq këto certifikata janë të vlefshme për 3 vite.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 98, Paragrafi 1, 2 dhe 3.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 99, Paragrafi 1, 2 dhe 3.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 25.

#### 4. TRANSPARENCA

Mungesa e transparencës në proceset e prokurimit rrezikon në plan të parë llogaridhënien dhe shton mundësitë e rritjes së korrupsionit dhe keqpërdorimeve. Organizatat vendore dhe ato ndërkombëtare vazhdimisht potencojnë në raportet e tyre se Ligji aktual për Prokurimin Publik nuk krijon transparencë të mjaftueshme, apo në raste të caktuara minimizon mundësinë e qasjes në proces.

Edhe raporti i progresit i Komisionit Evropian për vitin 2011 nënvizon mungesën e nevojshme të transparencës. Sipas këtij raporti, mos-harmonizimi i ligjit me direktivat e BE-së, duke lejuar mundësinë e ndërhyrjes dhe presionit politik në prokurim, ka minuar transparencën dhe llogaridhënien. Në këtë raport i kërkohet OSHP-së t'i publikojë vendimet e saj në ueb-faqen zyrtare.

Një element që do të rriste transparencën dhe do të zvogëlonte hapësirat për keqpërdorime, konsiderohet Sistemi Elektronik i Prokurimit. Shumë vende tanimë kanë filluar implementimin e këtij sistemi, siç është rasti me Shqipërinë, e ku megjithatë niveli i transparencës kërkon rritje.

Ndërkohë, sa i përket ligjit, nene të veçanta kanë konsideruar mundësinë e transparencës. Neni 10 i këtij ligji flet për promovimin e transparencës në proceset e prokurimit.

“1. Autoriteti kontraktues mban një përmbledhje të rregulluar dhe gjithëpërfshirëse të të dhënave për secilin aktivitet të prokurimit që e kryen, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në dhënien e kontratës ose konkursit të projektimit.

2. Shënimet për secilin aktivitet të prokurimit duhet të përmbajnë se paku: (i) të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmbyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në një kontratë ose në dhënien e konkursit të projektimit, dhe (ii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në dhënien e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e tillë, dhe (iii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në ekzekutimin e një kontrate publike, atëherë një kopje të kontratës publike dhe të të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me kontratën dhe/ose ekzekutimin e saj. Dokumentacioni në lidhje me ekzekutimin e kontratës përfshinë në veçanti planin e menaxhimit të kontratës i kërkuar sipas nenit 81 të këtij ligji.

3. Me kërkesën e cilitdo person, autoriteti kontraktues i siguron qasje të menjëhershme dhe të arsyeshme personit të tillë, i cili kërkon të ketë qasje

---

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 87, Paragrafi 1.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 94, Paragrafi 1.  
Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 95, Paragrafi 1.

në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1. dhe 2. të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste, që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënie e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitetet ishin përmbyllur”.

Por, në nenin pasues paraqitet një lloj pengese në rastet e interesit për të pasur qasje nga jashtë. Mundësia që i lihet operatorit që nëpërmjet një kërkesë për ta cilësuar si sekrete dokumentacionin, shumë herë është vlerësuar si e padrejtë për faktin se ekziston rreziku potencial që shumë operatorë ta kërkojnë këtë të drejtë, e që automatikisht do të nënkuptonte edhe uljen e shkallës së transparencës.

Në nenin 11, tek Informatat Sekrete Afariste, thuhet se: “Pa prejudikuar detyrimin për t’u siguruar palëve të interesuara dhe publikut qasje në shënimet e aktiviteteve të tij të prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të respektojë dhe të mbajë si sekret informatat e klasifikuara si informata sekrete afariste në përputhshmëri me këtë nen”. Kjo dispozitë e minimizon transparencën, ani pse ato informata janë sekrete afariste. Megjithatë, ka tre kritere të veçanta që disa informata të konsiderohen afariste, dhe ligji kërkon të arsyetohen pse disa informata duhet të jenë sekrete afariste.

E ndërkohë, paradoksi më i madh sa i përket transparencës në prokurimin publik ishte ajo që krijonin rregulloret e UNMIK-ut në vitin 1999. Rregullorja e UNMIK-ut “Instruksioni i administrimit financiar Nr 2/1999”, që rregullonte prokurimin publik në atë kohë, i kishte dhënë hapësirë maksimale qasjes publike. Në nenin 8, pika 8.3 krijonte transparencë të plotë sa i përket të interesuarve për të pasur qasje në procedurat tenderuese.

“8.3.1 ORPP dhe çdo njësi e prokurimit, në lokalet e veta, mbajnë një zyrë apo bibliotekë të hapur për të gjithë anëtarët e interesuar të shoqërisë. Në çdo zyrë ose bibliotekë të tillë, për të gjithë anëtarët e interesuar publik me kohë sigurohen kopjet e dokumenteve të ORPP dhe të dokumenteve të kërkuara sipas paragrafit 8.1 dhe, pas dhënies së kontratës, sipas paragrafit 8.2 duhet të mirëmbahen dhe të publikohen. Të gjithë personat kanë të drejtë t’i kontrollojnë dhe kopjojnë të gjitha këto dokumente në aparatin

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 10, Paragrafi 1, 2 dhe 3.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 11, Paragrafi 1.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 11, Paragrafi 3.

fotokopjues, i cili mund të shfrytëzohet lirisht në këto lokale. 8.3.2 Përcjellja dhe regjistrimi i çdo faze të procesit të prokurimit, në të cilin janë përfshirë më shumë se një furnizues është i lejueshëm për publikun”

Ligji i ri ka kontribuar në rritjen e transparencës duke rregulluar “publikimin e njoftimeve”. Aty kërkohet që secili Autoritet Kontraktues të dërgojë të gjitha njoftimet, duke përfshirë njoftimin paraprak, njoftimin për kontratë, njoftimin për dhënie të kontratës dhe njoftimin për anulim në KRPP për publikim në ueb-faqen zyrtare të KRPP-së (<http://krpp.rks-gov.net>). Legjislacioni megjithatë, nuk përfshinë njoftimin për kuotime apo njoftim për kontratë me vlerë të vogël, që përfshinë kontratat më të vogla, nga 1,000 euro deri në 10,000 euro. Andaj, rekomandohet që kjo fushë të rregullohet me ndryshim plotësimin e legjislacionit në të ardhmen.

Sa i përket dosjeve të tenderit, dorëzimi i dosjeve të tenderit rregullohet me ligj. Autoritetet Kontraktuese tanimë mund t'ia dorëzojnë Operatorëve Ekonomik dosjen e tenderit pa pagesë, pas kërkesës me shkrim nga këta të fundit. Kjo ndihmon transparencën, ul kostot e aplikimit për Operatorët Ekonomik, si dhe ndikon në përshtatshmërinë e afateve kohore, të cilat janë rregulluar me ndryshimet e fundit në legjislacion.

Për ta rritur llogaridhënien dhe cilësinë e punëve, është futur edhe një nen i ri, i cili rregullon aktivitetet e menaxhimit të Kontratës. Përkatësisht, pasi të jetë nënshkruar kontrata, Autoriteti Kontraktues do ta emërojë një Menaxher të Projektit që është përgjegjës për menaxhimin e kontratës specifike. Ndërkaq, Menaxheri i Projektit do të përgatis një plan për menaxhimin e kontratës, duke përdorur formularin standard “Plani për Menaxhimin e Kontratës”, për të cilin dokument duhet të bien dakord palët kontraktuese para inicimit të zbatimit të kontratës.

Një ndryshim themelor në të mirë të transparencës, është bërë me “Nenin 10, Mjetet për Promovimin e Transparencës”. Me ligjin e vjetër, qasja në dokumentacion nga Operatorët Ekonomikë ishte e mundur vetëm 10 ditë pas datës së publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, ndërkaq ankesat nuk mund të bëheshin pas 8 ditëve pas publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës. Pra, afati i parashtrimit të ankesave skadonte para se të mund të kishin qasje në dokumentacion. Me ligjin e ri, qasja sigurohet menjëherë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës.

---

Rregullorja e UNMIK-ut, “Instruksioni i administrimit financiar Nr 2/1999

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 19, Paragrafi 3.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 48.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 5.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 81.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 10.

## 5. SANKSIONET

Ligji për Prokurimin Publik, në pjesën e fundit flet për mjetet juridike, dispozitat ndëshkimore dhe përfundimtare. Pavarësisht rregullimit ligjor, përkatësisht masave të parapara, raportet e punës së institucioneve që janë të thirrura për ta zbatuar ligjin prezantojnë raste të pakta të ndëshkimeve.

Në nenin 130, pika 1 dhe më pas në pikat 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 kur flitet për ndikimin e paligjshëm, parashihen masat si në vijim:

“1. Pa paragjykuar dhe sipas ligjit përkatës penal dhe ligjit tjetër në fuqi, konsiderohet shkelje e këtij ligji, e dënueshme dhe e zbatueshme në pajtim me ligjin në fuqi përkatës për çdo person:

1.1. sigurojë, ofrojë, kërkojë, ose pranojë ose të tregojë gatishmëri për të siguruar, ofruar, kërkuar ose pranuar diç që është e vlefshme (duke përfshirë, por pa u kufizuar në, para, ofertë pune, pasuri materiale dhe jo-materiale, favorizim ose shërbime) për përfitimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose pasurimin e punonjësit ose të ish punonjësit, zyrtarit ose ish zyrtarit të një autoriteti kontraktues, ose të një personi apo ndërmarrje që ka lidhje me ose që bashkëpunon me punonjësin, ish punonjësin, zyrtarin ose ish zyrtarin, në tërësi ose pjesërisht për të ndikuar ose tentuar për të ndikuar në vendimin ose masat që dëmtojnë, ose lidhen me iniciimin, zbatimin ose rezultatet e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit;

1.2. të ndërmarrë masa, ose të tregojë gatishmëri për të marrë masa, me qëllim të frikësimit, shtrëngimit, dëmtimit ose shkaktimit të dëmit (fizik, financiar ose të ndryshëm) të ndonjë personi ose ndërmarrje, në tërësi ose pjesërisht me qëllim që të ndikojë, të tentojë të ndikojë ose të hakmerret për një vendim ose veprim lidhur me iniciimin, zbatimin ose rezultatin e aktivitetit të prokurimit ose shqyrtimit.

1.3. të kërkojë ose të hyjë në çfarëdo marrëveshje, aranzhim ose mirëkuptim me çfarëdo personi ose ndërmarrje tjetër, nëse marrëveshja, aranzhimi ose mirëkuptimi i tillë ka për qëllim që të ndikojë ose të parandalojë, kufizojë ose të ngatërroj konkurrencën për cilëndo kontratë publike; ose

1.4. të ia lehtësojë ose ta inkurajojë cilindo person ose ndërmarrje që të merret me cilëndo nga veprimet e specifikuar në pikat “1.1”, “1.2” ose “1.3” më lartë”.

Ndërkohë, katër pikat pasuese të këtij neni i shqyrtojnë raportet që duhen pasur çdo person me organet përgjegjëse në rastet kur vihen në dijeni për keqpërdorime.

E nga ana tjetër, neni 131 flet për Shkeljet e Ligjit nga Autoriteti Kontraktues. “OSHP-ja do të vendosë një gjobë prej jo më pak se pesëmijë (5.000) Euro për autoritetin kontraktues që nuk zbaton një urdhër ose për mosrespektimin e urdhrit të OSHP-së brenda pesë (5) ditëve.”

Në lidhje me specifikimet teknike, legjislacioni e ndalon Autoritetin Kontraktues që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë Operatorë Ekonomikë, përkatësisht: “Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.” Megjithatë, edhe pse ndalohet, ligji nuk parasheh sanksione të qarta në rast të thyerjes së kësaj dispozite ligjore, ndaj zyrtarëve të prokurimit publik apo ndaj të gjithë institucionit përkatësisht Autoritetit Kontraktues.

Me nenin 118 e ligjit të ri për Prokurimin Publik, përkatësisht Siguria, Gjobat dhe Dënimet, është zvogëluar shuma e sigurimit të ankesave. Me ligjin paraprak, shuma e sigurisë ka qenë 5 % e vlerës së kontratës (por jo më pak se 1,000 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro), ndërsaq me Ligjin e ri, është zvogëluar në 500 Euro. Kjo ka ndikuar në rritjen e numrit të ankesave të shqyrtuara nga OSHP si dhe mund të kuptohet si ndikim në përmirësimin e gabimeve gjatë procesit tenderues. Në fund, kjo tarifë prej 500 Eurove duhet ti kthehet ankuesit kurdo që OSHP e miraton ankesën si të bazuar, që do të thotë Operatori Ekonomik i merr 500 Eurot e paguara në fillim nëse OSHP ka vendosur në favor të tij.

Një dispozitë ligjore shumë e rëndësishme e Ligjit aktual është edhe Neni 99 për Funkcionet dhe Kompetencat e OSHP-së që ka lidhje me sanksionet ndaj Operatorëve Ekonomikë që dorëzojnë dokumentacione false. Në bazë të një kërkesë me shkrim nga Autoriteti Kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të falsifikuara nga Operatori Ekonomik, “OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë Operatorin Ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim për një periudhë deri 1 vjeçare”. Përpilimi i një “Liste të Zezë” të tillë ishte rekomanduar edhe nga organizatat e shoqërisë civile.

---

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 131.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 28, Paragrafi 2.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011), Neni 99, Paragrafi 2.



## 6. STANDARDET EVROPIANE LEGJISLACIONI I BE-SË PËR PROKURIMIN PUBLIK

Tregu i Brendshëm i Bashkimit Evropian (BE-së) është krijuar për të garantuar lëvizjen e lirë të të mirave, kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve përbrenda tanimë 27 anëtarëve të BE-së. Dhënia e kontratave për punë publike për blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga autoritetet e ndryshme publike, si të nivelit të institucioneve të BE-së po ashtu edhe të institucioneve qendrore, lokale apo të pavarura të vendeve anëtare të saj, përbën një prej çështjeve themelore për funksionimin e këtij Tregu të Përbashkët të BE-së.

Por, rregullimi i çështjes së prokurimit publik daton qysh në vitin 1962 kur atëherë Këshilli i Ministrave të Komuniteteve të Evropës vendosi për heqjen e kuotave dhe kufizimeve tjera në prokurimin publik. Më pas në vitin 1985 Komisioni Evropian miratoi Letrën e Bardhë që kishte të bënte me barrierat jo-tarifore për lëvizjen e lirë të të mirave dhe shërbimeve në Evropë. Dhe kështu në vitet e 90-ta ishin hartuar edhe disa direktiva të cilat ishin konsoliduar dhe kishin të bëjnë me sektorin e shërbimeve, furnizimeve, punëve dhe shërbimeve komunale.

Duke qenë se në vitin 2002 praktikat në prokurimin publik nuk siguronin një konkurrencë të shëndoshë ndërmjet firmave që funksiononin përbrenda të gjithë anëtarëve të BE-së dhe kishte një transparencë të mangët në këtë drejtim, prokurimi publik jo rastësisht quhej edhe “lidhja më e dobët në Tregun e Përbashkët”. Me qëllim të thjeshtëzimit dhe sqarimit të legjislacioni paraparak, lindi nevoja e hartimit të direktivave të reja, të cilat duheshin të transpozoheshin në legjislacionin kombëtar deri më së largu më 31 janar 2006, e të cilat janë:

- Direktiva 2004/17/EC për koordinimin e procedurave të prokurimit të entiteteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare, dhe
- Direktiva 2004/18/EC për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave publike të furnizimit dhe kontratave publike të shërbimeve.

Ndërkaq në vitin 2007 u azhurnuan edhe Direktivat e mjeteve juridike për sa i përket përmirësimit të efikasitetit të procedurave të shqyrtimit në lidhje me dhënien e kontratave publike, përkatësisht Direktiva 2007/66.

Katër Liritë e BE-së

Sipas ueb portalit Europa.eu, the EU Single Market, 24 maj 2012

Bovis, Christopher H. (2007): EU Public Procurement Laë. Elgar European Laë Series. Edëard Elgar Publishing. ISBN 978-1-84720-947-4.

Duke qenë se transparenca rrit konkurrencën e çmimeve ndërmjet furnitorëve e që rezulton në çmime më të ulëta të blerjes, ajo luan një rol të rëndësishëm në prokurimin publik të BE-së. Që furnitorët të informohen më shumë për mundësi biznesi, dhe në këtë mënyrë të rritet transparenca, prokurimi publik në BE është i organizuar në mënyrën e publikimit të tre lloj njoftimeve në Gazetën Zyrtare, duke përfshirë:

- Njoftimet Indikative Periodike (PIN) që paraqet vëllimin vjetor të llogaritur të prokurimit për çdo autoritet kontraktues,
- Ftesat formale për tenderime që furnitorët të dorëzojnë ofertat e tyre për të filluar procesin e dhënies së një kontrate, dhe
- Njoftimet për Dhënien e Kontratave (CAN) të cilat e njoftojnë publikun e gjerë për dhënien e kontratës ofertuesit të suksesshëm, duke përfshirë çmimin dhe arsyen e përzgjedhjes.

Pragjet minimale janë elementi tjetër i rëndësishëm në prokurimin publik të BE-së. Parimet e pragjeve minimale i lejojnë autoriteteve të mënjanojnë një proces tenderues të kushtueshëm dhe që merr kohë, dhe në këto raste përdorin procedura për vlera të ulëta të kontratave ku shpenzimet e procedurës do të kalonin përfitimet e mirëqenies publike. Këto parime gjithashtu i nxisin autoritetet të ndajnë kontratat në pjesë të ndara me qëllim të shmangies së procedurave të mërzitshme. Edhe pse Direktivat ndalojnë veprime të tilla, një shmangie e tillë e ligjit të prokurimit është e vështirë për tu zbuluar. Pragjet minimale ndryshojnë nga 125,000 € për kontratat e furnizimit dhe shërbimit për sektorin publik të autoriteteve qendrore qeverisëse, në 4,845,000 € për kontratat e sektorit publik dhe shërbimeve komunale, si dhe për kontratat që janë të subvencionuara më shumë se 50% nga shteti dhe që përfshijnë aktivitete të inxhinierisë civile apo objekteve spitalore, sportive, rekreative apo edukuese.

Varësisht nga lloji i kontratës, përkatësisht nëse ajo është për furnizim, punë apo shërbim, ka disa procedura të ndryshme prokurimi për autoritetet publike, që i përcaktojnë kufizimet e tyre në autoritetin prokurues, dhe përfshijnë:

- Procedura e Hapur, ku të gjitha palët e interesuara mund të dorëzojnë ofertat e tyre ndaj thirrjes për oferta, por autoriteti publik e ka të drejtën të shqyrtojë të gjitha apo vetëm një numër të caktuar të ofertave të cilat i përmbushin kriteret e kërkuara.

---

Sikurse janë ndryshuar dhe plotësuar herën e fundit me Rregullën 1177/2009 të datës 30 nëntor 2009.

Direktiva 2004/18/EC, neni 7 (a).

Direktiva 2004/18/EC, nenet 7 (c) dhe 8 (a).

Out Law, <http://www.out-law.com/page-5964> më datë 25 maj 2012



- Procedura e Kufizuar, ku të gjitha palët mund të shfaqin interes në tenderim, por vetëm ata që i përmbushin kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara nga autoriteti publik ftohen të tenderojnë.
- Procedura e Negociuar, ka dy forma të cilat janë pa publikim të thirrjes për tenderim – ku autoriteti mund të negociojë direkt me furnizuesin që dëshiron, dhe me publikim të thirrjes për tenderim.
- Procedurat Konkurruese të Dialogut, që lejon kontributin e operatorëve ekonomikë, dhe gjatë dialogut palët mundën individualisht t'i diskutojnë të gjitha aspektet e kontratës me autoritetin kontraktues.

Megjithatë, në legjislacionin e BE-së ekzistojnë edhe forma të veçanta të prokurimit, sikurse Marrëveshja Kornizë, dhe Partneriteti Publiko-Privat. Marrëveshja Kornizë është një marrëveshje ombrellë, që i përcakton kushtet në lidhje me çmimin, cilësinë dhe sasinë, mbi të cilën kontratat individuale mund të bëhen përgjatë një periudhe kohore të marrëveshjes (normalisht deri në 4 vite). Ndryshe nga Marrëveshjet Kornizë, Partneriteti Publiko-Privat nuk është pjesë e Direktivave të përmendura të BE-së, por rregullohet me Traktatet e ndryshme dhe me legjislacion tjetër dytësor.

Përfundimisht, BE po rishikon legjislacionin mbi prokurimin publik. Në një komunikatë të lëshuar për Aktin e Tregut të Vetëm, thuhet se “Komisioni do të përgatisë propozim-legjislacionet deri më së largu në vitin 2012, me qëllim të thjeshtëzimit dhe azhurnimit të rregullave evropiane, që dhënia e kontratave të bëhet më fleksibile dhe që kontratat publike të mund të vihen në përdorim më të mirë në mbështetje të politikave tjera”. Në janar 2011 Komisioni publikoi një Letër të Gjellbër mbi modernizimin e prokurimit publik, ndërkaq në dhjetor 2011 Komisioni publikoi propozimet për rishikimet e Direktivave mbi prokurimin publik dhe prokurimin në sektorin e shërbimeve komunale dhe për nxjerrjen e një Direktive të re mbi dhënie të kontratave të koncesionit. Komisioni gjithashtu ka sjellë përpara edhe propozime mbi qasjen e furnitorëve nga “shtetet e treta” në tregun e prokurimit publik të BE-së.

Duke qenë se këto propozime po diskutohen dhe negociohen ndërmjet grupeve të interesit dhe Parlamentit Evropian në Bruksel, pritet që ato të aprovohen në fund të vitit 2012, dhe kjo nënkupton se këto direktiva do të duhej të inkorporoheshin në legjislacionin e secilit shtet të BE-së deri më së largu në qershor 2014. Kjo nënkupton

Direktiva 2004/18/EC, nenet 9, 11, dhe 32.

Qeveria Skoceze, shikuar më datë 25 maj 2012

<http://www.scotland.gov.uk/Topics/Government/Procurement/policy/eurevieçprocurement>

Konsultimet Publike, shikuar më datë 25 maj 2012

[http://ec.europa.eu/internal\\_market/publicprocurement/modernising\\_rules/consultations/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/modernising_rules/consultations/index_en.htm)

Qeveria Skoceze, shikuar më datë 25 maj 2012

<http://www.scotland.gov.uk/Topics/Government/Procurement/policy/eurevieçprocurement/countryaccess>

gjithashtu se edhe legjislacioni i Kosovës mund dhe duhet të inkorporojë këto ndryshime nga fillimi i vitit 2013.

## RAPORTET E PROGRESIT TË KOMISIONIT EVROPIAN PËR KOSOVËN (2008 – 2011)

Duke qenë se Kosova është një shtet kandidat potencial për anëtarësim në BE, Komisioni Evropian monitoron dhe përcjell hartimin dhe zbatimin e legjislacionit në Kosovë. Në këtë mënyrë, çdo vit Komisioni Evropian vlerësimin e vetë e bënë publik nëpërmjet Raporteve të Progresit, të cilat mbi të gjitha e vënë theksin në atë se sa legjislacioni i Kosovës është në përputhshmëri me Acquis Communautaire. Prokurimin publik Raporti i Progresit (Raporti) e shtjellon si pikë të veçantë në kuadër të kriterit ekonomik. Këtu do të paraqiten vetëm vlerësimet e dhëna në Raportet nga viti 2008 deri në vitin 2011, dhe atë vetëm për zhvillimet në legjislacionin e kësaj fushe.

Në Raportin e vitit 2008, nënvizohet që Ligji i Prokurimit Publik (LPP, i ndryshuar dhe plotësuar në vitin 2007) ishte “në përgjithësi në përputhje me standardet evropiane” dhe që në të ishin përcaktuar procedura të detajuara të prokurimit. Megjithatë, theks të veçantë i vihej mospërputhjeve në përkthim në tre gjuhët ku kërkohet të ndërmerreshin veprime të menjëhershme në mënyrë që të sigurohej saktësia ligjore.

Një keqësim të situatës në lidhje me legjislacionin në fushën e prokurimit publik e prezantojnë Raportet e viteve 2010 - 2011. Në vitin 2010, Komisioni Evropian nuk ishte i kënaqur me draft-Ligjin e Prokurimit Publik që ishte dorëzuar në Kuvend nga Qeveria, duke i paralajmëruar institucionet se “dispozitat në lidhje me koncesionet” në draft-ligjin e propozuar ishin qartazi në kundërshtim me legjislacionin e BE-së (acquis). Ndërkaq, në Raportin e vitit 2011, duke komentuar projekt-ligjin për prokurimin publik të miratuar në nëntor 2010, konstatohet se ai përmbante një numër të dispozitave që nuk ishin në përputhje me Direktivat e BE-së mbi prokurimin publik, e aq më keq, nënvizohet se këto dispozita ligjore “ekspononin zyrtarët e prokurimit në ndërhyrje dhe presion politik”. Me këtë rast, aty theksohet se ishin minuar transparenca dhe llogaridhënia e gjithë procesit, duke hapur mundësi për korrupsion.

Por, i njëjti Raport (2011) vuri në dukje një version të ri të ligjit që ishte miratuar në gusht 2011, i cili adresonte shumicën e mangësive të ligjit paraprak, dhe i cili ishte më shumë në përputhshmëri me standardet e BE-së, ku përfshihej edhe pavarësia e zyrtarëve të prokurimit. Megjithatë, ky Raport, i fundit, vlerëson se legjislacioni mbi prokurimin publik nuk është në përputhje me standardet evropiane, duke sugjeruar që Kosova të kompletojë dhe përmirësojë Ligjin për partneritetin publiko-privat dhe që të ndryshohen

dhe plotësohen pjesa e koncesioneve në mënyrë që të plotësohen kërkesat e legjislacionit të BE-së.

Gjithashtu analizohet edhe përcaktimi ligjor i rolit të institucioneve kryesore të prokurimit publik, përkatësisht të Komisionit Regullativ të Prokurimit Publik (KRPP), Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), dhe të Agjencisë Qendrore të Prokurimit (AQP). Raporti i vitit 2009 jep vërejtje për mungesën e legjislacionit dytësor, përkatësisht për mospërgatitjen e këtij legjislacioni dytësor nga KRPP, që është edhe një prej detyrave kryesore të këtij institucioni. Por Raporti i fundit vuri në dukje lëshimin e disa instruksioneve administrative, që mbi të gjitha e rregullojnë edhe gjuhën në dokumentet e prokurimit publik, hapjen publike dhe ekzaminimin e ofertave, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, përdorimin e kriterit të përzgjedhjes, etj. Ndërkaq, OSHP-së i bëhet thirrje ti publikojë vendimet e saj në ueb-faqen zyrtare të saj. Mbi të gjitha, Raporti i fundit (2011) thekson se në legjislacionin aktual ka përzjerje të detyrave dhe përgjegjësiive ndërmjet tri institucioneve të prokurimit publik, dhe rekomandon ndarjen e fuqive rregullatore dhe ekzekutive.

Kritikohet edhe legjislacioni mbi trajnimin edhe certifikimin e zyrtarëve të prokurimit, i cili precizonte që “çdo zyrtar i prokurimit duhet të bënte së paku 10 ditë trajnim të obligueshëm për çdo vit”. Vërejtja ishte se megjithatë sistemi i atëhershëm i certifikimit parashihte vetëm një trajnim për tërë jetën, që nuk ishte në përputhje me ligjin. Por raportet tjera theksonin se kjo ishte përmirësuar, duke nënvizuar atë se certifikata të përhershme për prokurim do ti lëshoheshin zyrtarëve që përfundojnë trajnimin me sukses vazhdimisht përgjatë tre viteve të njëpasnjëshme. Kurse Raporti i fundit vë në dukje ndryshimin në ligj, duke rritur numrin e ditëve që zyrtarët e prokurimit duhet të trajnoheshin, përkatësisht nga 10 deri në 15 ditë trajnimi për një vit. Për më tepër, llogaridhënia për procesin e prokurimit, në (Raporti 2010), rekomandohej të zgjerohej, në mënyrë që të mos përfshijë vetëm zyrtarët e prokurimit, por edhe eprorët e tyre, si në nivelin administrativ gjithashtu edhe në nivelin politik.

Sa i përket trajnimit të zyrtarëve të prokurimit nga Instituti i Administratës Publike, me ligj parashihet edhe trajnimi i sektorit privat. Por, duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara, IKAP nuk është duke e bërë një gjë të tillë. Me këtë rast, do të ishte e rekomanduar që me ligj të jetë e detyrueshme që IKAP të bëjë trajnimin për prokurim publik edhe për sektorin privat, kjo duke pasur parasysh mungesën e njohurive në raste të caktuara të sektorit privat për funksionimin e kësaj fushe.

Në përgjithësi, Raporti i fundit përfundon se legjislacioni mbi prokurimin, posaçërisht ai mbi prokurimin publik, ende nuk është në përputhshmëri me standardet evropiane. Andaj rekomandohet që struktura ligjore e prokurimit të kompletohet dhe përmirësohet.

## 7. PRAKTIKAT NGA RAJONI

Edhe vendet e rajonit, duke qenë se janë në rrugën e tyre të integritimit në Bashkimin Europian, ballafaqohen me probleme të njëjta apo të ngjashme në fushën e prokurimit publik. Raporti i progresit 2011 për vendet fqinje, respektivisht Shqipërinë, Kroacinë, Maqedoninë dhe Serbinë dëshmon kryesisht progres dhe avancim mesatar në fushën e prokurimit publik si dhe vë në pah mangësi të caktuara sa i përket legjislacionit të prokurimit publik në këto vende. Përfundimisht progresi në kornizën legjislative të prokurimit publik vërehet të kenë bërë Maqedonia dhe Kroacia. Të dhënat në vijim janë përmbledhje nga Raporti i Progresit 2011.

### SHQIPËRIA

Sipas Raportit të Progresit 2011 Shqipëria nuk shënon sukses sa i përket principeve të përgjithshme, kornizës legjislative të prokurimit publik dhe koncesioneve që nuk përputhen plotësisht me Acquis Communautaire, në raport me vitin paraprak.

Sipas Raportit, kompetencat e të gjitha institucioneve të prokurimit ku përfshihet Agjencia e Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Avokati i Prokurimit Publik nuk janë të përcaktuara qartë, ku kërkohet që në mënyrë që të mos ngatërrohen detyrat dhe përgjegjësitë dhe të pastrohet sistemi nga paqartësitë ligjore, të përkufizohen këto përgjegjësi.

Transparenca dhe konkurrenca mbetet e dobët. APP posedon mjete kufizuese për monitorim të përputhshmërisë me legjislacionin e prokurimit publik. Për këtë arsye është legjislacioni sekondar i paraparë nga ligji për prokurim publik ai i cili nuk është miratuar dhe stafi aktual i APP-së nuk e lejon atë të shkarkoj detyrat në mënyrë të duhur.

Megjithatë progresi vërehet në fushën e shpërblimit të kontratave publike të cilat tanimë janë përfshirë në kornizën ligjore të prokurimit publik. Progres është shënuar gjithashtu në fushën e mjeteve juridike. Këshilli i Ministrave aprovoi vendimet mbi funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, duke përfshirë rishqyrtimin e procedurave apeluese dhe përcaktimit të pagesave të tarifave.

Me përjashtim të progresit të këtyre dy fushave, përgatitjet e përgjithshme në prokurimin publik të Shqipërisë, në Raportin e Progresit të BE-së, karakterizohen me avancim mesatar.

## MAQEDONIA

Raporti i Progresit vlerëson se Maqedonia ka arritur progres në lidhje me parimet e përgjithshme, transparencën në dhënien e kontratave publike si dhe në sistemin e mjeteve juridike. Njësia përgjegjëse e koncesioneve në Ministrinë e Ekonomisë ka përmirësuar bashkëpunimin me institucionet e tjera të përfshira në prokurimin publik.

Progresi i Maqedonisë në fushën e prokurimit publik vërehet tek procedurat e prokurimit të cilat janë bërë më transparente dhe zbatimi i tyre është rritur por kapaciteti administrativ i autoriteteve kontraktuese mbetet i dobët. Ambienti ligjor i zbatimit të mjeteve juridike theksohet të jetë përmirësuar. Edhe pse në përgjithësi përgatitjet e Maqedonisë në fushën e prokurimit publik janë mjaft të avancuara, raporti i progresit 2011 prezanton edhe një varg dobësish. Mes tjerash përmendet që legjislacioni për koncesionet dhe partneriteteve publike-private ende nuk është në linjë me ligjet dhe direktivat e BE-së. Kapaciteti administrativ në fushën e mjeteve juridike mbetet i dobët. Edhe pse Byroja Publike e Prokurimit vazhdon bashkëpunimin me Zyrën Shtetërore të Auditimit, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës, statistikave gjyqësore në prokurimin publik që lidhen me rastet gjyqësore duhet të përforcohen.

Në fund aty vlerësohet se kapaciteti i njësive përgjegjëse për koncesione në Ministrinë e Ekonomisë mbetet i pamjaftueshëm për t'u marrë me projekte të mëdha.

## SERBIA

Serbia karakterizohet me progres minimal në fushën e prokurimit publik në krahasim me vitin paraprak, gjithmonë duke u bazuar në Raportin e Progresit të BE-së. Ndër mangësitë theksohet të jenë vonesa në krijimin e një Komisioni të ri për Mbrojtjen e të Drejtave të Ofruesve Tenderues, si dhe ato të legjislacionit aktual duke përfshirë mungesën e një kornize të duhur rregullative për koncesion. Në dallim nga Kosova, Shqipëria e Maqedonia ku ofrohen trajnime të zyrtarëve të prokurimit publik, në Serbi ceket që certifikimi i zyrtarëve të prokurimit publik ende nuk ka filluar.

Koordinimi i mekanizmave në mes të grupeve kryesore të interesit në sistemin e prokurimit publik për synim të eliminimit të korrupsionit mbetet i dobët. Strategjia për

përmirësimin e sistemit të prokurimit publik mbetet në fazën fillestare. Si rezultat, siç është vërejtur nga raporti buxhetor 2008 i Institucionit Suprem të Auditimit, pamjaftueshmëritë në përdorimin e parasë publike vazhdojnë të mbesin aty ku kanë qenë. Po ashtu ajo që vazhdon të mbetet aty ku ka qenë është edhe kapaciteti i dobët administrativ i organeve të prokurimit publik e sidomos njësia e prokurimit publik në Ministrinë e Financave, PPO-ja si dhe organi shqyrtues.

## KROACIA

Kroacia është e vendosur të jetë shteti-anëtar i 28<sup>te</sup> i Bashkimit Evropian me 1 korrik të vitit 2013. Këtë e dëshmon edhe progresi në fushën e prokurimit publik. Kroacia ka miratuar ligjin e ri për prokurim publik në korrik të vitit 2011, i cila është gati tërësisht në linjë me legjislacionin e BE-së.

Implementimi i vazhdueshëm i politikave në fushën e prokurimit publik si dhe përmirësimi i koordinimit të mekanizmave dhe ngjarjeve trajnuese, ka bërë që transparenca dhe llogaridhënia e sistemit të rritet.

Procesi i përforcimit të Agjencisë për Partneritetin Publik-Privat ka vazhduar. Udhëzimi për APPP është hartuar dhe publikuar në linjë me sistemin e ri ligjor. Stafit të APPP-së ka marrë pjesë në kurse trajnuese në fushën e koncesioneve dhe PPP-së në bashkëpunim me institucionet e tjera kyçe në këtë sektor. Komisioni Shtetëror për Mbikëqyrje të Procedurave të Prokurimit Publik ka vazhduar përpjekjet e tij në përmirësimin e menaxhimit të mjeteve ligjore. Transparenca dhe llogaridhënia e këtij komisioni është përmirësuar edhe me ueb-faqen e re të përditësuar.

Vëmendje e veçantë kërkohet t'i kushtohet legjislacionit dytësor të ligjit të ri për prokurim publik me qëllim që të mirëmbahet koordinimi i mekanizmave, të ngritën kapacitetet institucionale në sektor përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe zhvillimit profesional të stafit të tyre. Më konkretisht, përpjekje të mëtutjeshme nevojiten për ndërtimin e kapaciteteve të Komisionit Shtetëror. Përpjekje të mëtutjeshme nevojiten për finalizimin e harmonizimit të legjislacionit sekondar në lidhje me Aktin e Koncesioneve dhe të përmirësohet kapaciteti administrativ i Departamentit të Koncesioneve. Ngritja e mëtutjeshme e kapacitetit administrativ dhe përmirësimi i kualitetit të dokumenteve tenderuese nevojitet po ashtu në Zyrën Qendrore të Prokurimit, e cila edhe pse kapacitetet i ka ndërtuar në mënyrë graduale.

Raporti i Progresit 2011 dëshmon avancim mesatar në fushën e prokurimit publik në shtetet fqinje, më saktësisht në Shqipëri, Maqedoni e Serbi, dhe avancim të shkëlqyer në Kroaci.

Korniza ligjore në prokurimin publik dhe koncesionet në Shqipëri nuk vlerësohet të jetë në linjë me ligjet dhe direktivat e BE-së. Sugjerohet të bëhen përpjekje më të mëdha pikërisht në përmirësimin e kornizës institucionale dhe në përcaktimin sa më saktë të institucioneve të prokurimit publik në mënyrë që të shmanget ngatërrimi i detyrave apo përgjegjësive dhe të mënjanoen paqartësitë dhe mospërputhshmëritë në sistem.

Pavarësisht suksesit të dëshmuar në fushën e prokurimit publik në Maqedoni, respektivisht parimeve të përgjithshme, transparencës gjatë shpërblimit të kontratave si dhe sistemin e mjeteve juridike, Raporti i Progresit rekomandon përmirësimin e legjislacionit për koncesione dhe partneriteteve publike-private si dhe përforcimin e kapaciteteve administrative në fushën e mjeteve juridike. Gjithashtu, i njëjti rekomandim vlen edhe për Serbinë, mangësia kryesore e së cilës në legjislacionin aktual qëndron tek mungesa e një kornize të duhur rregullative për koncesione.

## 8. GRUPET E INTERESIT

Publikime në fushën e prokurimit publik dhe legjislacionit të prokurimit publik janë bërë nga organizata të ndryshme joqeveritare dhe nga institucione të ndryshme hulumtimi. Lëvizja FOL, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP), RIINVEST, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, INPO, janë disa nga këto institucione të cilat kanë bërë analiza sa i përket versioneve të ndryshme të legjislacionit si dhe kanë prezantuar rekomandime të ndryshme me qëllim të përmirësimit të kornizës ligjore e cila do të promovonte rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në fushën e prokurimit publik.

Fol konsideron se promovimi i nivelit të transparencës si mjeti thelbësor në luftimin e korrupsionit në prokurimin publik sipas Ligji Nr.04/L-42, rrezikohet përmes disa mangësive sikurse që është Neni 3 i këtij ligji i cili përfshin rastet përjashtuese të aktiviteteve të caktuara të prokurimit publik në zbatim të këtij ligji. FOL konsideron që këto përjashtime cenojnë transparencën e procedurës së shpërblimit të kontratës, ndikojnë në rritjen e kostove të financimit të tyre si dhe rritet rreziku i shfaqjes së veprimeve korruptive me rastin e shpërblimit të këtyre kontratave.

FOL ka hartuar një varg rekomandimesh për një draft të ri të Ligjit të Prokurimit Publik drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me 31 maj 2011. Përbërë gjithsej nga 25 rekomandime FOL përmes tjerash cek rëndësinë e vendosjes së prokurimit publik elektronik në



Kosovë, reduktimit të burokracisë si dhe sigurimit të transparencës dhe llogaridhënies përmes procedurave të thjeshta, të hapura dhe efektive. FOL rekomandoi që KRPP-ja të hartojë raporte periodike çdo 3 muaj për zbatimin e kontratave nga qeverisja qendrore dhe ajo lokale, të cilat do të shqyrtohen në seancë të Kuvendit dhe në mbledhje të Qeverisë.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GSJP) në publikimin e tyre Modelet e Ndryshme të (Keq)Përdorimit të Parasë Publike: Trendet dhe praktikët e menaxhimit të prokurimit publik në komunat e Kosovës, gjithashtu ka rekomanduar digjitalizimin e procesit të prokurimit duke konsideruar abuzive që tenderët publikë dhe mënyra se si merren vendimet janë të fshehura nga publiku në përgjithësi. Sipas GSJP-së, digjitalizimi i procesit të prokurimit i cili duhet të përfshijë të drejtën e pretendentëve në secilin proces tenderues, me rastin e dhënies së kontratës, të kenë qasje në metodën e vendimmarrjes dhe çdo detal tjetër të procedurës duke ia lejuar publikut të gjerë qasjen në shumicën e detajeve të procesit të tenderimit, duke përfshirë përmbledhjen e shënimeve të procedurës së monitorimit të zbatimit. Po ashtu kjo do të lejonte që niveli i transparencës në tenderë komunalë të rritej shumë, përderisa vendimet e drejta të prokurimit të rrisnin besimin e publikut në procesin e tillë.

Sipas GSJP, planifikimin i aktiviteteve vjetore të prokurimit në mënyrë të duhur dhe rigoroze do të mënjanonin veprimet “më partiak” të komunave duke mundësuar që vendimmarrja për agjendën e prokurimit të jetë sa më transparente dhe e qasshme për të gjithë.

Gjithashtu, GSJP konsideron se vendosja e kritereve më rigoroze të prokurimit do të mënjante përdorimin e autoritetit nga ana e qeverive komunale në dhënie të tenderëve publik firmave të tyre të preferuara partiake. GSJP prandaj sugjeron vendosjen e një mekanizmi rigoroz në KRPP që do të mbikëqyrte besimin komunal. KRPP-ja vazhdimisht do të lëshonte direktiva dhe rregullore ligjore me qëllim që të luftoj abuzimet e qeverive lokale në bazë të saj.

Themelimi i “Listës së Zezë” rekomandohet edhe nga Lëvizja FOL edhe nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Kjo listë iu referohet operatorëve ekonomikë të cilët kanë abuzuar më tenderët publik. GSJP thekson që Lista e Zezë është e domosdoshme për integritetin e procesit të performancës së prokurimit dhe do të shërbente si ndalesë për të drejtën e aplikimit për ata operatorë ekonomikë të cilët kanë abuzuar në të kaluarën me tenderë publikë dhe thekson që kjo ndalesë do të duhet të rregullohet saktësisht me ligj

---

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2012): Modelet e Ndryshme të (Keq)Përdorimit të Parasë Publike: Trendet dhe praktikët e menaxhimit të prokurimit publik në komunat e Kosovës.



dhe afat kohor. Fol këtë afat kohor e rekomandon të jetë dy (2) vite. Një formë e ngjashme parashihet me legjislacionin aktual, përkatësisht Neni 99, por vlen vetëm për dokumentacionin e rremë, por jo edhe për keq-menaxhimin apo probleme me zbatimin e kontratave nga Operatorët Ekonomik.

GSJP po ashtu rekomandon nivel më të madh të auditimit të jashtëm, duke sugjeruar që ZAP dhe KRPP t'i rrisin kapacitetet e tyre për auditim sidomos në lidhje me performancën e tenderëve të dhënë e jo veç rregullsisë së procedurave sa i përket procedurës së dhënies së tenderit. Ajo çka kërkohet është të ofrohet monitorim dhe vlerësim gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm.

Në lidhje me prokurimin publik është marrë edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Në një publikim të titulluar Agjenda e Biznesit të Kosovës, duke u bazuar në ankesat e shumta të bizneseve lidhur me specifikat teknike, sugjerojnë që ato duhet shkruar nga ekspertë të fushës për të cilën shpallet tenderi. Për më tepër, ata kërkojnë të ndalohen praktikrat e anulimit të tenderëve në mënyrë arbitrare që të kihet parasysh koha, paratë dhe munda që shpenzohen nga kompanitë, duke mbajtur përgjegjës ata që i anulojnë prokurimet publike pa dhënë arsye të faktike siç parashihet me ligj (LPP, paragrafi 1, neni 62).

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, duke u bazuar në informatat e marra nga bizneset anëtare të saj, kërkon që vonesat në përgjigjet në pyetjet e kompanive duhet të eliminohen dhe parashtruesve duhet të iu ofrohen të gjitha informatat me kohë, siç kërkohet me ligj. Në anën tjetër, ata vlerësojnë se organet prokurore apo komisionet për vlerësimin e tenderëve duhet të ndalojnë praktikrat e varësisë së tepërt në kriterin e çmimit më të ulët, duke u bazuar edhe në kritere tjera. Gjithashtu, kjo Odë Ekonomike rekomandon që kontratat të mos nënshkruhen deri sa të mos jenë shfrytëzuar të gjitha mekanizmat e ankesave.

Sa i përket mangësive ligjore të cilat kanë karakterizuar legjislacionin e prokurimit publik, mund të ceket edhe konkluzioni i Iniciativës për Progres INPO në analizën e tyre Prokurimi Publik në nivel Lokal – Problemet dhe sfidat e funksionit të zyrave të prokurimit të komunave të Ferizaj, Kaçanikut dhe Shtimes për periudhën tetor 2010- prill 2011, ku theksohet që ndryshimi i shpeshtë i legjislacionit publik ka ndikuar që operatorët ekonomikë të hasin në vështirësi që ta kuptojnë atë.

Raporti i progresit Made in Kosova, i publikuar në tetor të vitit 2010, thekson që paqartësitë më të mëdha në Ligjin për Prokurim Publik dhe nënshkrimin e kontratave janë krijuar nga Qeveria e Kosovës e cila me obligimin e ministrave dhe zyrtarëve të tjerë

administrativ, u është dhënë rëndësi e barabartë zyrtarëve profesional të prokurimit me përfaqësuesit politik. Sipas këtij raporti, kjo mënyrë e nënshkrimit të kontratave shkakton zvarritjen e mëtutjeshme të procedurave tenderuese.

Punimet analitike të grupeve të interesit, dëshmojnë mangësitë e vazhdueshme që karakterizojnë legjislacionin e prokurimit publik. Këto mangësi cenojnë transparencën si dhe japin hapësirë për akte korruptive. Si shembull u konsiderua neni 3 i Ligjit aktual i cili përjashton raste të caktuara nga obligimet ligjore në prokurimin publik.

Qasja e barabartë dhe transparente e të gjithëve në proceset tenderuese mundësohet përmes digjitalizimit të procesit të prokurimit dhe rekomandohet nga GSJP si dhe nga FOL. Të dy këto institucione po ashtu theksojnë domosdoshmërinë për krijim e një “Liste të Zezë” e cila do t'i përfshinte emrat e operatorëve ekonomik të cilat kanë abuzuar më detyrën e tyre dhe limiti kohor i cili duhet të përcaktoj pjesëmarrjen e tyre konkurruese në të ardhmen.

Megjithatë, ligjërisht ekziston një masë e cila përjashton operatorët që falsifikojnë dokumente. Neni 99, paragrafi i dytë mbi funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, i lejon këtij institucioni të drejtën edhe për të përjashtuar operatorët që paraqesin ankesa me dokumente të falsifikuara. Sipas këtij neni, në bazë të një kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare.

## 9. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Analizimi i legjislacionit të prokurimit publik në Republikën e Kosovës, dhe krahasimi i tij me legjislacionin e Bashkimit Europian dhe të shteteve fqinje, vë në pah mangësi dhe zbrazësi ligjore të aspekteve të ndryshme të kësaj fushe.

Rregullimit aktual ligjor në situata të caktuar minimizon transparencën. Për më tepër, në masë të konsiderueshme, edhe institucionet përgjegjëse në prokurimin publik i shmangen detyrimeve për të qenë më transparentë kundrejt opinionit. Një vlerësim i përgjithshëm i akterëve që lidhen me prokurimin publik konsideron se ngritja e transparencës dhe llogaridhënies është shumë e nevojshme, kjo në mënyrë që të rritet siguria menaxhimin e drejtë të parasë publike. Edhe Raporti i Progresit për Kosovën i vitit 2011 thekson se është minuar transparenca dhe llogaridhënia e gjithë procesit, duke hapur mundësi për korrupsion.

Rritja e transparencës, në mënyrë që të rritet llogaridhënia, kërkohet edhe nga institucionet konkrete. Në Raportin e Progresit 2011, OShP-së i bëhet thirrje t'i publikojë vendimet e saj në ueb-faqen zyrtare të saj. Një veprim i tillë, thelbësor për transparencën dhe llogaridhënien, rekomandohet të rregullohet edhe me dispozita dhe akte ligjore e nën-ligjore.

Ka edhe disa kontrata të cilat nuk kërkohet të publikohen. Duke qenë se legjislacioni aktual e kërkon publikimin e vetëm kontratave me vlera më të mëdha se 10,000 euro, rekomandohet, që kur të bëhet ndryshim-plotësimi i legjislacionit aktual, të rishikohet edhe mundësia e publikimit të kontratave me vlerë të vogël (nga 1,000 euro deri në 10,000 euro). Kjo kërkesë do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe mirinformimin e operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë me kuotimet e tyre për kontrata me vlerë të vogël.

Një rekomandim i radhës - që vjen edhe nga shoqëria civile - ka të bëjë me Komisioni Rregullativ të Prokurimit Publik. Kërkohet që njoftimet e KRPP-së të përfshijnë jo vetëm fituesin e tenderit, por edhe ofertuesit e tjerë - në mënyrë që të identifikohen rastet e nepotizmit, dhe të dihet se çka është njësia dhe vlera totale e projektit. Për më tepër, nga organizatat përfaqësuese të biznesit rekomandohet që ky organ duhet të përpilojë një listë me çmime për njësi për produktet më të përdorshme dhe kërkuara nga Autoritetet Kontraktuese, në mënyrë që kjo listë të jetë pikë referuese për çmimet që ofrohen nga operatorët ekonomikë.

Mirëpo, zgjidhje konkrete për këtë do të ishte përdorimi i një sistemi elektronik të prokurimit, "e-procurement", që do të zgjidhte përgjithmonë problemin e transparencës dhe llogaridhënies së menaxhimit të parasë së taksapaguesve kosovarë.

Sa i përket trajnimeve të zyrtarëve të prokurimit publik, vlerësohet riorganizimi i këtyre trajnimeve me qëllim avancimet në aspektin e edukimit të tyre. Megjithatë, rekomandohet, që procesi i trajnimit të mos ndalet vetëm tek zyrtarët e prokurimit, por që të rregullohet me ligj që IKAP të detyrohet të trajnojë edhe një numër të caktuar të zyrtarëve të prokurimit të Operatorëve Ekonomikë në vit.

Se a ka nevojë të rishikohet, ndryshohet e plotësohet legjislacioni mbi prokurimin publik në Kosovë, nuk do komentim. Mirëpo, duke qenë se edhe vetë Bashkimi European është duke e rishikuar legjislacionin në fushën e prokurimit publik, dhe duke marrë parasysh që edhe legjislacioni i fushës së prokurimit publik në Republikën e Kosovës ka nevojë të ndryshohet dhe plotësohet, rekomandohet që kjo të ndodhë pasi të jenë bërë këto ndryshime në sistemin ligjor të BE-së. Një veprim i tillë do të ndikonte në minimizimin e ndërhyrjeve në legjislacion. Përndryshe, edhe ashtu legjislacioni në këtë fushë ka pasur ndërhyrje të tepërta, fenomen që ka krijuar konfuzion tek operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktuese.

Akterë të shumtë ndërkohë kanë ngritur edhe shqetësime tjera sa i përket sidomos masave ndëshkuese për keqpërdoruesit dhe shkelësit në proceset e prokurimit publik. Me këtë rast, rekomandohet, që me ligj të rregullohet përpilimi i Listës së Zezë nga OSHP-ja, që do të përfshinte jo vetëm Operatorët Ekonomikë që kanë prezantuar dokumente të rreme – sikurse rregullohet momentalisht, por edhe Operatorët Ekonomik të cilët kanë keq-menaxhuar parat e taksapaguesve e ata që nuk kanë zbatuar në përpikëri kontratat e dhëna nga Autoritetet Kontraktuese, për një afat kohor prej 2 viteve.

Një aspekt tjetër tepër i rëndësishëm vlerësohet të jetë edhe nevoja e zbatimit më të mirë të Ligjit për Prokurimin Publik. Vërejtjet më të mëdha të atyre që nuk favorizojnë ndryshimin e ligjit, insistojnë në nxitjen e institucioneve kompetente që ta zbatojnë Ligjin. Sipas këtyre vlerësimeve, shumë pengesa që paraqiten në procedurat e prokurimit, lidhen me mungesën e zbatimit të plotë të ligjit.

Po ashtu, kërkohet sensibilizim i operatorëve ekonomik edhe sa i përket kontratave, sepse raportohet që shpeshherë paraqiten raste kur, një, operatorët ekonomik nuk i dallojnë llojet kontratave, dhe dy, ata i nënshkruajnë kontratat pa i lexuar nenet përbërëse të tyre pra nëse mund ti përmbushin ato kërkesa apo jo. Specifikacioni teknik në ofertat e publikuara shpeshherë paraqitet si problem që ndikon në rritjen e numrit të parregullive dhe keqpërdorimeve. Vlerësohet se shpeshherë, fituesi i tenderit vendoset duke manipuluar me specifikacionet teknike të ofertave. Rekomandohet që me përcaktimin e kushteve për ofertuesit, të përcaktohen kritere dhe specifikacione standarde.

## 10. BIBLIOGRAFIA

### LEGJISLACIONI:

- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (5 tetor 2011).
  - Ligji Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (16 nëntor 2010-i shfuqizuar).
  - Ligjin Nr. 2003/17 për Prokurimin Publik në Kosovë (1 janar 2008-i shfuqizuar).
  - Ligjin Nr. 02/L-99 për Prokurimin Publik (1 qershor 2008-i shfuqizuar).
  - Ligjin Nr. 03/L-158 për Prokurimin Publik (10 gusht 2009-i shfuqizuar).
- Rregullorja e UNMIK-ut, “Instruksioni i administrimit financiar Nr 2/1999” (e shfuqizuar).
- Direktiva 2004/17/EC për koordinimin e procedurave të prokurimit të entiteteve që operojnë në sektorët e ujit, energjisë, transportit dhe shërbimeve postare.
- Direktiva 2004/18/EC për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave publike të furnizimit dhe kontratave publike të shërbimeve.
- Raportet e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën dhe Rajonin (2008-2011), Pika 4.1.6: Prokurimi publik.

### INSTITUCIONET:

- Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP (<http://krpp.rks-gov.net>).
- Agjencia Qendrore e Prokurimit – AQP (<http://aqp.rks-gov.net/>).
- Organi Shqyrtues i Prokurimit – OSHP (<http://oshp.rks-gov.net/>).
- Instituti Kosovar për Administratë Publike – IKAP (<http://ikap.rks-gov.net>).

### PUBLIKIMET DHE BURIMET JERA:

- Bovis, Christopher H. (2007): EU Public Procurement Laë. Elgar European Laë Series. Edëard Elgar Publishing. ISBN 978-1-84720-947-4.
- Grupi për Studime Juridike dhe Politike (2012): Modelet e Ndryshme të (Keq)Përdorimit të Parasë Publike: Trendet dhe praktikat e menaxhimit të prokurimit publik në komunat e Kosovës.
- INPO, KDI, RIINVEST, KPJ, FOL, QKSS, YIHR (tetor 2010): Raporti i progresit Made in Kosova 2011, përkrahur nga Fridrich Ebert Stiftung.
- Konsultimet Publike, shikuar më datë 25 maj 2012  
[http://ec.europa.eu/internal\\_market/publicprocurement/modernising\\_rules/consultations/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/internal_market/publicprocurement/modernising_rules/consultations/index_en.htm).
- Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (shtator 2011): Agjenda e Biznesit të Kosovës.
- Out Law, <http://www.out-law.com/page-5964> më datë 25 maj 2012.
- Prokurimi Publik në nivel Lokal – Problemet dhe sfidat e funksionit të zyrave të prokurimit të komunave të Ferizaj, Kaçanikut dhe Shtimes për periudhën tetor 2010- prill 2011, nga INPO.
- Qeveria Skoceze, shikuar më datë 25 maj 2012  
<http://www.scotland.gov.uk/Topics/Government/Procurement/policy/eurevieëprocurement>.
- Qeveria Skoceze, shikuar më datë 25 maj 2012  
<http://www.scotland.gov.uk/Topics/Government/Procurement/policy/eurevieëprocurement/countryaccess>.
- Sipas ueb portalit Europa.eu, the EU Single Market, 24 maj 2012.